



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:247515

Datë: 19.04.2023

Numri i dokumentit: 04199834

PKR.nr.44/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti për Krime të Rënda, me Kryetarin e trupit gjykues Shaqë Curri, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Selvane Bukleta, në çështjen penale ndaj të pandehurit A.D., për shkak të veprës penale, rrezikim i trafikut publik, nga neni 370 par.5 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe veprës penale mosdhënia e ndihmës personit të lënduar në fatkeqësinë e trafikut publik, nga neni 374 par.3 të KPRK-së dhe të pandehurit N. D., për shkak të veprës penale, mosdhënia e ndihmës, nga neni 188 par.4 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti për Krime të Rënda PP/I.nr.330/22 të dt. 02.03.2023, mbajti seancën publike të shqyrtimit fillestar me datë 03.04.2023 në prezencë të Prokurorit të shtetit Ersan Qavolli, të pandehurit A.D., mbrojtësit të tij av. K.P., sipas autorizimit, të pandehurit N. D., mbrojtësi të tij av. H.S., sipas autorizimit, përf. ligjor i tani të ndjerit –babai E. Sh., si dhe përf. i aut. i palës së dëmtuar av. S. M., me dt. 06.04.2023 bie dhe shpalli publikisht, ndërsa me dt.19.04.2023 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të pandehurit

A.D., i biri idhe nënës, e gjinisë, i lindur me dt., në S., me vendbanim në fsh. B., Rr.“.....”, K. S., me lnj.nr....., i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i R. se Kosovës, gjenden nën masën e paraburgimit nga data 22.11.2022 e tutje.

N. D., i biri idhe nënës, e gjinisë, i lindur me dt., në fsh. B., K. S., me vendbanim në fsh. B., Rr. “ .”, K. S., me lnj.nr....., i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i R. se Kosovës, gjenden nën masën e paraburgimit nga data 23.11.2022 e tutje.

JANË FAJTORË

Për shkak se:

I pandehuri A.D.:

I. Me datën 21.11.2022 rreth orës 06:45min, në fshatin Jashanicë K. Klinës, shkel ligjin mbi trafikun publik dhe atë nenin 53 par. 1 dhe 231 par. 1 dhe me këtë tjetrit i shkakton vdekjen dhe atë viktimës/të ndjerit F.Sh., në atë mënyrë që, derisa i pandehuri, pa pas patentë shofer po drejtonte kamionin e markës “Mercedes Atego” i cili ishte i pa regjistruar dhe jo i rregullt teknikisht, në të cilën kishte rimorkion e kamionit dhe një rimorkio shtesë për transport ekskavatorësh, me të arritur fshatin e lartcekur, drejtimi Skenderaj – Klinë, nuk e përshtat shpejtësinë e lëvizjes në raport me kushtet e rrugës dhe e tejkalon atë nga 50km/h sa ishte e lejuar në mbi 90km/h dhe kalon në të majtë në shiritin e kundër qarkullues, ku po qarkullonte me automjetin e tij të markës “Opel” i ndjeri F. Sh., ku me pjesën e parë të anës së majtë të rimorkios e godet automjetin Opel në pjesën e parë ballore të anës së majtë, pikërisht në pjesën ku ndodhej viktima, i cili nga lëndimet e pësuar si rezultat i aksidentit, ndërron jetë,

- me këtë ka kryer vepër penale **“rrezikimi i trafikut publik”** nga neni 370 par. 5 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

II. Me datën 22.11.2022 rreth orës 06:45min, në fshatin Jashanicë K. Klinës, rrugën Skenderaj – Klinë, si ngasës i kamionit “Mercedes Atego”, nuk i ofron ndihmë personit tjetër i cili është lënduar në aksidentin e trafikut të shkaktuar me kamionin e të pandehurit, nga ku edhe rezulton me vdekjen e të viktimës F. Sh., në mënyrën që, pasi i pandehuri shkakton aksidentin e trafikut të përshkruar si në dispozitivin e parë të aktakuzës, ndalon kamionin dhe së bashku me prindin e tij/të pandehurin N. D., dalin nga kamioni afrohen afër viktimës por nuk i ofrojnë ndihmë dhe largohen nga vendi i ngjarjes, gjersa viktima ndërron jetë,

- me këtë ka kryer vepër penale **“mosdhënia e ndihmës personit të lënduar në fatkeqësinë e trafikut publik”** nga neni 374 par. 3 të KPRK-së.

I pandehuri N. D.:

III. Me datën 21.11.2022 rreth orës 06:45min, në fshatin Jashanicë K. Klinës, rrugën Skenderaj – Klinë, nuk i ofron ndihmë personit tjetër, jeta e të cilit është ndodhur në rrezik të drejtpërdrejt edhe pse këtë ka mundur ta bëjë pa rrezik të madh për vete apo tjetrin, ndërsa nga kjo ka rezultuar me vdekjen e personit të rrezikuar dhe atë viktimës, tani të ndjerit F. Sh., në atë mënyrë që, pasi i pandehuri A.D., shkakton aksidentin e trafikut me kamion sikurse në dispozitivin e parë të kësaj aktakuze, ku i pandehuri N. ishte pasagjer në të, ashtu që i pandehuri A. ndalon kamionin dhe së bashku me prindin e tij/të pandehurin N. D., dalin nga kamioni, afrohen afër viktimës por nuk i ofrojnë ndihmë dhe largohen nga vendi i ngjarjes, gjersa viktima ndërron jetë,

- me këtë ka kryer vepër penale **“mosdhënia e ndihmës”** nga neni 188 par. 4 i KPRK-së.

Andaj, gjykata duke u bazuar në nenin 7, 38, 40, 69, 70, 76, 370 par.5 lidhur me par. 1 të KPRK-së, nenit 374 par.3 të KPRK-së, nenit 188 par. 4 të KPRK-së, nenit 364 të KPRK-së, të pandehurit i:

G J Y K O N

Të pandehurin A.D.

- Për veprën penale, rrezik i trafikut publik, nga neni 370 par. 5 lidhur me par. 1 të KPRK-së, nga dispozitivi i parë i këtij aktgjykimi, i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 8 (tetë) viteve.

- Për veprën penale, mosdhënia e ndihmës personit të lënduar në fatkeqësinë e trafikut publik nga neni 374 par. 3 të KPRK-së, nga dispozitivi i dytë i këtij aktgjykimi, i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tri) viteve.

Konform nenit 76 të KPRK-së, të pandehurit A.D., gjykata i shqipton dënim unik me **burgim prej 10 (dhjetë) viteve**, në të cilin dënim do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej dt. 22.11.2022 e tutje, e të cilin dënim do ta mbaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të pandehurin N. D.

- Për veprën penale, mosdhënia e ndihmës nga neni 188 par. 4 të KPRK-së, i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 5 (pesë) viteve, në të cilin dënim do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej dt. 23.11.2022 e tutje, e të cilin dënim do ta mbaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të pandehurit secili veç e veç obligohen që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 100 (njëqind) euro, në afat prej 30 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit.

Të pandehurit secili veç e veç obligohen që në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit të paguajnë, shumë prej 50 (pesëdhjetë) euro, në afat prej 30 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit.

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti për Krime të Rënda, ka ngrit aktakuzë PP/L.nr.330/22, të dt. 02.03.2023, ndaj të pandehurit A.D., për veprën penale rrezikim i trafikut publik, nga neni 370 par.5 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe veprën penale mosdhënia e ndihmës personit të lënduar në fatkeqësinë e trafikut publik nga neni 374 par.3 të KPRK-së dhe të pandehurit N. D., për veprën penale mosdhënia e ndihmës nga neni 188 par.4 të KPRK-së.

Me dt. 03.04.2023, është mbajtur seanca publike e shqyrtimit fillestar, në të cilën seancë kanë qenë prezent, Prokurori i Shtetit, Ersan Qavolli, i pandehuri A.D., mbrojtësi i tij av. K.P., sipas autorizimit, i pandehuri N. D., mbrojtësi i tij av. H. S., sipas autorizimit, përf. ligjor i tani të ndjerit –babai E. Sh. si dhe përf. i aut. i palës së dëmtuar av. S. M..

Gjykata konform dispozitave të nenit 241 par. 1 të KPP-së, e ka udhëzuar të pandehurit me të drejtat e tyre, ku në këtë rast të pandehurit kanë deklaruar se i kanë kuptuar këto të drejta dhe se për mbrojtës i pandehuri A. ka angazhuar sipas autorizimit av. K. P. dhe i pandehuri N. D. ka angazhuar sipas autorizimit av. H. S..

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, kryetari i trupit gjykues, pasi që është bindur se të pandehurit e kanë kuptuar aktakuzën, iu është dhënë mundësia të pandehurve që të deklarohen për pranimin ose mospranimin e fajësisë, duke i njoftuar për rëndësinë dhe pasojat e pranimin të fajësisë.

I pandehuri A.D., e ka pranuar fajësinë për të dy veprat penale për të cilat akuzohet, ju shpreh keqardhje familjes së dëmtuar, ju shpreh ngushëllime në emrin e tij dhe të familjes së tij, i vie keq që ka ndodh kjo fatkeqësi dhe ndjehet i penduar. Sa i përket dënimit ka shtuar se e përkrah fjalën e mbrojtësi të tij.

Mbrojtësi i të pandehurit A., av. K. P., ka deklaruar se ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë, nga ana e të mbrojturi të tij, i njëjti është njoftuar për benefitet dhe pasojat që rrjedhin nga pranimi i fajësisë, dhe i njëjti e ka pranuar fajësinë në mënyrë vullnetare të sinqertë, pranimin e fajësisë e ka bërë edhe para pjesëtarëve të policisë, para prokurorit të shtetit për aksidentin që ka ndodh ditën kritike, në të cilin aksident ka humbur një anëtarë i familjes Sh., kërkon nga gjykata që të aprovohet pranimi i fajësisë nga ana e të mbrojturit të tij. Njëkohësisht ka deklaruar se i mbrojturi i tij është i moshës relativisht të re, madhor i ri, asnjëherë më parë nuk ka ra ndesh me ligjin, kjo është hera e parë që i njëjti është ballafaqohet me ligj. I mbrojturi i tij është ushqyes i vetëm i familjes, gjithashtu kërkon që të merret si rrethanë lehtësuese, e posaçërisht lehtësuese dhe duke u bazuar në rrethanat lehtësuese që kishte pranimi i fajësisë, pendimi në veprën e kryer, të mbrojturit të tij ti shqiptohet një dënim i arsyeshëm.

I pandehuri N. D., ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, ju kërkon falje familjes Sh., i shpreh ngushëllime në emrin e tij dhe familjes, duke shtuar se ma me dëshirë kishë pa djalin e tij aty se të ndjerin, ndjehet i penduar si ndaj familjes Sh. dhe tek Perëndia dhe do të jetë i penduar deri sa të është gjallë. Lidhur me dënimin ka shtuar se e përkrah fjalën e mbrojtësi të tij.

Mbrojtësi i të pandehurit N., av. H. S., lidhur me pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i tij ka deklaruar se, pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit të tij N. D., një pranimi i tillë i fajësisë është i vullnetshëm dhe pa asnjë lloj ndikimi i cili është marr pas konsultimeve të mjaftueshme që ka pasur me të duke ia shpjeguar të gjitha benefitet por edhe pasojat e pranimin të fajësisë. Mbrojtja ka deklaruar që në emrin e tij dhe të familjes D., i shpreh keqardhje për rastin që ka ndodh, ashtu që i propozon gjykatës që ta aprovon pranimin e fajësisë nga ana e të

mbrojturit të tij. Lidhur me dënimin i propozon gjykatës që me rastin e marrjes së vendimit mbi dënim të merr parasysh si rrethana lehtësuese pranimin e vullnetshëm e fajësisë në të gjitha fazat e procedurës penale, por edhe në shqyrtimin fillestar, pendimin e thellë të të mbrojturit të tij për veprën penale të kryer, është hera e parë që ka ra ndesh me ligjin, i njëjti ka gjendje të vështirë ekonomike dhe familjare, ashtu që i propozon gjykatës që të njëjtit ti shqiptojë një dënim sa më të butë, me të cilin dënim do të arrihet efekti i dënimit.

Përf. i aut. i palës së dëmtuar, av. S. M., ka deklaruar se si mbrojtje nuk ka mund ta kundërshtojë pranimin e fajësie, meqenëse as prokurori nuk e ka kundërshtuar, por shton se ky pranim i fajësisë është bërë me të vetmin qëllim që të përfitohet sipas ligjit sikurse pranimi i fajësisë të ishte i bazuar në pendimin e tyre të thellë dhe të sinqertë gjë që nuk ka ndodh. Duke shtuar ndër të tjera se, këtu se nuk po gjykohet thjeshtë një aksident trafiku, por po gjykohet një krim i kryer me dashje, madje me dashje të ndërtuar edhe para kryerjes së veprës penale. Edhe gjatë shqyrtimit fillestar i pandehuri A.D. tha se me profesion është kamionist dhe të ushtrosh profesionin e kamionistit pa pas patentë shofer është haptas shprehje e dashjes apo pajtimit të tij, që në çdo rast të ngasjes ta rrezikojë jetën e ndonjë personit. Se ka ekzistuar dashja e tyre edhe para kryerjes së veprës penale, natyrisht si dashje eventuale kanë dëshmuar edhe dëshmitarët L.K. dhe Sh.K. nga të cilët janë huazuar kamioni dhe rimorkio që të dyjat të paregjistruara të parregullta teknikisht, fakte që ua kanë treguar të pandehurve, mirëpo edhe përkundër kësaj ata janë pajtuar që ti përdorin këto mjete duke qenë të vetëdijshëm se pikërisht kjo do të mund të jetë shkak për një aksident trafiku. Dashja e tyre demonstron edhe për të pandehurin A.D., edhe në mospërfilljen ekstreme të rregullave të trafikut duke e drejtuar automjetin e tyre me mbi 90 km/h, që është për së paku 40 km/h mbi shpejtësinë e lejuar dhe gjithnjë duke qenë të vetëdijshëm për parregullsitë teknike dhe automjetit dhe rimorkios. Prokurori tha se si rrethanë rënduese duhet të vlerësohet edhe mënyra e kryerjes së veprës penale ku hyjnë të gjitha këto veprime, por edhe veprimet pas kryerjes së veprës që tregojnë një sjellje tejet jo humane dhe monstruoze të cilët pasi që u binden se tani i ndjeri F., është i gjallë, ata e lanë në gjendje të tillë nga frika se ai nesër mund të shpëtojë dhe mund të jetë dëshmitarë i krimit. Ndryshe nuk ka si të arsyetohet sjellja e një njeriut normal dhe të përgjegjshëm që pasi të kuptojë se viktima e veprimit të tij është gjallë, ta lë në atë gjendje dhe ta ketë prioritet fshehjen e gjurmëve të veprës penale. Pra këta nuk menduan për humanizëm, nuk menduan se po e lënë një jetë të njeriut në duar të fatit, por u larguan nga vendi i ngjarjes që ti fshehin gjurmët e këtij krimi. Kjo sjellje e tyre nuk përfundon me kaq, ata erdhën në vendin e tyre të punës, u përpoqën ti maskojnë gjurmët e krimit duke e kthyer automjetin tek pronari i saj, ndërkaq duke qenë se rimorkio ishte e dëmtuar, nuk patën guxim t'ia kthejnë të zotit nga frika se do të zbulohen, por këtë detyrë ia besuan L.K. duke e futur edhe atë në kufi të përgjegjësisë në mënyrë perfide pa ditë asgjë se çka ka ndodh. Të pandehurit vazhduan kështu për dy ditë, u sjellën në mënyrë krejt normale, vazhduan punën e tyre dhe kjo tregon për mungesën ekstreme të asaj që është njerëzore pa i munduar fare përgjegjësia që mendonin se u varros së bashku me viktimën. Në fund përfaqësuesi i palës së dëmtuar ka shtuar se e di se pranimi i fajësisë paraqet rrethanë lehtësuese për këdo që e pranon fajësinë, pendohet sinqerisht dhe e ndjen shkallën e përgjegjësisë për veprën që e ka kryer por në këtë rast pranimi i fajësisë është edhe një përpjekje që të përfitojë nga ligji, pa asnjë lloj shprehje të keqardhjes, pa asnjë lloj shprehje të pendimit, pa asnjë lloj gatishmërie që ta sjell në vend atë që është më humane dhe më njerëzore, kërkim falja me rastin e marrjes në pyetje për

herë të parë, ajo ka munguar deri me sot edhe siç e pamë edhe me rastin e deklaramit mbi fajësinë. Sa i përket kërkesës pasurore juridike do ta realizojnë në procedurë civile.

Përf. ligjor i të ndjerit-babai E. Sh., ka deklaruar se, e mbështet fjalën e përf. të tij të autorizuar dhe ka shtuar se i pandehuri që u deklarua që me profesion është kamionist, çka do të thotë kamionist pa patentë shofer, por nuk e di si hetuesia a ka hetuar se ka ndonjë vepër të kryer më parë në trafik. I pandehuri A., gjatë vitit 2021 dhe 2022 i janë shqiptuar 12 tiketa trafikut rrugor, prej tyre dy janë nga 300 euro, një është 200 euro, dy është 150, e të tjerat më të vogla, si dhe është i përfshirë në dy aksidente para këtij rasti, në njërin është i dyshuari kryesor,. Në vazhdim ka deklaruar se fjalën e ka përgatit me shkrim, nga një kopje iu dorëzon palëve në procedurë. E cila është pjesë përbërëse e shkresave të lëndës.

Prokurori i shtetit, ka deklaruar se, nuk e konteston, pranimin e fajësisë për shkak se i njëjti ka mbështetje në shkresat e lëndës dhe është bërë në mënyrë vullnetare. Lidhur me dënimin prokurori ka deklaruar se meqenëse të pandehurit e kanë pranuar fajësinë, nuk është lëshuar fare në elaborimin e provave të cilat vërtetojnë gjendjen faktike të përshkruar sikurse në aktakuzë, mirëpo do t'i elaboroj vetëm rrethanat për caktimin e dënimit. Si rrethana rënduese me rastin e caktimit të dënimit për të pandehurit A. dhe N., i propozon që të merret për bazë mënyra e kryerjes së veprës penale, fakti se të pandehurit e kanë parë viktimën, por nuk i kanë ofruar ndihmë, si rrethanë tjetër rënduese të merret për bazë fakti, se i pandehuri A. nuk kishte patentë shofer, si rrethanë rënduese të merret për bazë fakti tjetër se kamioni ishte pa regjistrim dhe në gjendje jo të rregullt teknik, po ashtu si rrethanë rënduese të merret për bazë shkalla e lartë e pjesëmarrjes në kryerjen e kësaj veprë penale, si rrethanë rënduese të merret për bazë dëmi i shkaktuar i pariparueshëm. Po ashtu si rrethanë rënduese të merret për bazë sjellja e të pandehurve gjatë kryerjes e sidomos pas kryerjes së veprës penale, ku siç kanë deklaruar dëshmitarët J. B. dhe F. B., e njëjtë ka deklaruar edhe i pandehuri N. D., në seancën dëgjimore për caktimin e paraburgimit me dt. 24.11.2022, ku e pranon se ka dëgjuar të ndjerin duke thënë "oj nana jem", por edhe përkundër kësaj nuk i ofrojnë ndihmë, sjellje këto jo njerëzore dhe të papërfillshme madje tentojnë edhe të fshihen, ku vetëm pas ndërmarrjes së shumë veprimeve hetimore është arritur të bëhet arrestimi i tyre. Këto rrethana të trajtohen si posaçërisht rënduese. Nga të lartcekurat kërkon nga gjykata që të pandehurve të u shqiptojë dënim maksimal për këto vepra penale.

Vlerësimi i gjykatës

Kryetari i Trupit Gjykes është i bindur se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë konform dispozitave të nenit 241 dhe 242 par 1 të KPP-së, pasi që të pandehurit e kuptuan natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes dhe provat në të cilat edhe mbështet aktakuza siç janë: Raporti i autopsisë MA 22-365; Mendimi dhe konstatimi i ekspertit të komunikacionit rrugor (plotësimi) punuar nga eksperti Kreshnik Rugova dt. 24.01.2023; Fotografitë e pjesës së rimorkios; CD e kamerave të sigurisë lidhur me shkaktimin e aksidentit; Ekspertiza e makinerisë punuar nga eksperti Avdullah Hoxha dt. 27.12.2022 së bashku me CD; Mendimi dhe konstatimi i ekspertit të komunikacionit rrugor punuar nga eksperti Kreshnik Rugova dt. 18.12.2022; Mendimi dhe konstatimi i ekspertit Nol

Dedaj dt. 14.12.2022; Raporti i hetuesit Sokol Halilaj ref: 04/1-03NJRKR-R-HET-068-22 dt. 30.11.2022; Skica e vendit të ngjarjes; Raporti i aksidentit dt. 21.11.2022; Raporti nga konsulta për F. Sh. dt. 21.11.2022; Raporti i policit rr. Mentor Mala dt. 21.11.2022; Fotografitë e shkresave të lëndës; dhe Procesverbali mbi vendshiqimin e aksidentit dt. 21.11.2022, Procesverbali mbi marrjen e deklaratës së të pandehurit A.D. dhënë në P.TH. Pejë me dt. 01.03.2023; Procesverbali mbi marrjen e deklaratës së dëshmitarit F.B. dhënë në P.TH. Pejë me dt. 02.02.2023; Procesverbali mbi marrjen e deklaratës së dëshmitarit N.M. dhënë në P.TH. Pejë me dt. 02.02.2023; Procesverbali mbi marrjen e deklaratës së dëshmitarit G. M. dhënë në P.TH. Pejë me dt. 02.02.2023; Procesverbali mbi marrjen e deklaratës së dëshmitarit J. B. dhënë në P.TH. Pejë me dt. 02.02.2023; Procesverbali mbi marrjen e deklaratës së dëshmitarit Sh. K. dhënë në P.TH. Pejë me dt. 01.02.2023; Procesverbali mbi marrjen e deklaratës së dëshmitarit L. K. dhënë në P.TH. Pejë me dt. 18.01.2023; Procesverbali mbi marrjen e deklaratës së dëshmitarit F. B. dhënë në P.TH. Pejë me dt. 18.01.2023; Procesverbali mbi marrjen e deklaratës së dëshmitarit N. B. dhënë në P.TH. Pejë me dt. 18.01.2023; Procesverbali mbi marrjen e deklaratës së dëshmitarit F. B. dhënë në P.TH. Pejë me dt. 05.12.2022; Procesverbali mbi marrjen e deklaratës së dëshmitarit N. B. dhënë në P.TH. Pejë me dt. 05.12.2022; Procesverbali mbi marrjen e deklaratës së të pandehurit N. D. dhënë në P.TH. Pejë me dt. 05.12.2022; Procesverbali mbi marrjen e deklaratës së të pandehurit A.D. dhënë në P.TH. Pejë me dt. 05.12.2022; Procesverbali mbi marrjen e deklaratës së dëshmitarit L. K. dhënë në P.TH. Pejë me dt. 30.11.2022; Procesverbali mbi marrjen e deklaratës së palës së dëmtuar E. Sh. me dt. 29.11.2022; Procesverbali i marrjes në pyetje për të dyshuarin N. D. dhënë në st. pol. Pejë me dt. 23.11.2022; Procesverbali i marrjes në pyetje për të dyshuarin A.D. dhënë në st. pol. Pejë me dt. 23.11.2022; Deklarata e dëshmitarit F. B. dhënë st. pol. Klinë me dt. 22.11.2022; dhe Deklarata e dëshmitarit N. B. dhënë st. pol. Klinë me dt. 22.11.2022, si dhe shkresat e tjera të lëndës, pastaj aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore, ose gabim faktik, prandaj gjykata konform nenit 242 par 6 të KPP-së, ka pranuar pranimin e fajësisë nga të pandehurit.

Me provat e ofruara, si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit A.D. qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale rrezikim i trafikut publik, nga neni 370 par.5 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe veprës penale mosdhënia e ndihmës personit të lënduar në fatkeqësinë e trafikut publik nga neni 374 par.3 të KPRK-së dhe në veprimet e të pandehurit N. D. qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale mosdhënia e ndihmës nga neni 188 par.4 të KPRK-së.

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të pandehurve dhe të njëjtit janë penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 69 par.1 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurit secilin veç e veç gjykata mori, pranimin e fajësisë, dhe faktin se të pandehurit më parë nuk kanë qenë të dënuar për ndonjë vepër tjetër penale.

Rrethana rënduese ndaj të pandehurit A.D., gjykata mori faktin, se i pandehuri A. disa herë ka qenë i dënuar, më dënim kundërvajtës për shkak të shkeljes së ligjit mbi trafikun publik, ku nga

data baza e policisë shihet se i njëjti ka qenë i dënuar, mbi 10 (dhjetë) herë, për shkelje të ligjit mbi trafikun publike, e ku dënimi, në disa rast ka qenë deri në 300 euro, çka donë te thotë se vetëdija e të pandehurit, se është dukë e shkel Ligjin mbi trafikun publik, ka qenë e larët dhe dashja për ta shkelur ligjin mbi trafikun publik ka qenë e lartë, e ku si pasojë e shkeljes së këtij ligji, në këtë rast ka ardhë edhe deri të pasoja, ku ka humbur jetën F. Sh., po ashtu përveç faktit se nuk ka pas patentë shofer, e ka ditur se edhe kamionin dhe rimorkion e ka të paregjistruar që do të thotë edhe pa kontroll teknikë të sigurisë.

Po ashtu rrethana rënduese për të pandehurin A., e që kanë të bëjnë me veprën penale mosdhënia e ndihmës personit të lënduar në fatkeqësinë e trafikut publik, gjykata mori, shkalla e lartë e dashjes në kryerjen e kësaj veprë penale, ku i pandehuri edhe pse ishte ndalë në vend ngjarje, dhe e ka parë viktimën që ka nevojë për ndihmë, duke mos pasë farë konsideratë për jetën e një njeriut i cili ishte në rrezik, e duke e ditur se vetë ka qenë shkaktar i atij aksidenti, prapë se parape i pandehuri, nuk i ka ofruar ndihmë, por në ato momente e ka vlerësuar interesin e tij personal, duke dashtë ti ik edhe përgjegjësisë penale, largohet nga vendi i ngjarjes, pa i ofruar asnjë ndihem tani të ndjerit F. Sh.. I pandehuri A. edhe pse e ka ditur se është shkaktar i aksidentit, e ka vlerësuar si me të rëndësishme, mos zbulimin veprës dhe mosdhënia a përgjegjësisë para ligjit, se sa jeta e një personi që kishte nevojë për ndihmë. Rrethanë, rëndues gjykata mori faktin se viktimë në ato momente ka qenë posaçërisht e pambrojtur dhe e ndjeshme, e ku nevoja për ndihem ka qenë e madhe, rrethanë tjetër rënduese gjykata mori edhe moshën e re të viktimës dhe pasojat e shkaktuar nga vepra penale, ku viktimë ka lënë pasë veti një fëmijë të moshës se mitur. Rrethanë tjetër rëndues gjykata mori faktin se i pandehuri, pas kryerjes së veprës penale, ka bërë përpjekje, maksimale për fshehjen e veprës penale e ku vetëm pas ndërmarrjes së shumë veprimeve hetimore është arritur të bëhet arrestimi i tyre.

Rrethanë rënduese ndaj të pandehurit N.D., gjykata mori shkallë e larët te dashjes në kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet, ku i pandehuri me vetëdije të plotë edhe pse ishte ndalë në vendin e ngjarjes, dhe e ka pa viktimën në rrezik për jetë, i pandehuri largohet nga vendi i ngjarjes, duke mos pas farë konsideratë për jetën e një njeriut i cili në ato moment ishte në rrezik jetë, prapë se prapë i pandehurit N. e ka vlerësuar interesin e tij personal, që djali i tij, këtu i pandehuri A., për të mos dhënë përgjegjësisë për atë aksident, ka vendosur që mos ti ofroj ndihmën viktimës tani të ndjerit, e duke e ditur se viktimë në ato momente ka qenë posaçërisht e pambrojtur dhe e ndjeshme, e ku nevoja për ndihem ka qenë e madhe. Po ashtu rrethanë rëndues gjykata mori faktin se i pandehuri, pas kryerjes së veprës penale, ka bërë përpjekje, maksimale për fshehjen e veprës penale e ku vetëm pas ndërmarrjes së shumë veprimeve hetimore është arritur të bëhet arrestimi i tyre, si dhe rrethanë rëndues gjykata mori edhe moshën e re viktimës dhe pasojat e shkaktuar nga vepra penale, ku viktimë ka lënë pasë veti një fëmijë të moshës se mitur.

Sipas bindjes së gjyqtarit, dënimi i shqiptuar, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurve. Kryetari i Trupit Gjykses, gjithashtu ka konstatuar se me këto dënime mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre; të

parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Duke u bazuar ne nenin 449 par. 1 dhe 2 nën par. 2.6 të KPP-se, gjykata ka përcaktuar paushallin gjyqësor për secilin të pandehur veç e veç në shumë prej 100 euro, duke u bazuar ne shpenzimet që janë shkaktuar nga fillimi i kësaj procedure e deri në përfundimin e saj.

Konform nenit 36 par.1, 2, 3, nënpar.3.2 të ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, i obligoi në pagesën e taksë, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Konform nenit 462 par. 2 të KPP-së, për realizimin e kërkesës pasurore juridike palën e dëmtuar e udhëzoi në kontest civil.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 364 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 369 të KPP-së, gjykata përpiloi këtë aktgjykim.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti për Krime të Rënda
PKR.nr.44/22, dt. 19.04.2023

Bashkëpunëtore profesionale
Selvane Bukleta

Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari
Shaqë Curri

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.